



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRN	
Nr. / Br.	33713 / 26
Nr. i fq. / Br. st.	-2-
Data: / Datum:	28.07.2026
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 118/26, 27.07.2026

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 11 qershor 2026 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 14:20.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Stefan Markoviç (kryesues), Behar Duraku, Gresa Muli, Fakete Dushi, Diellza Pllana, Miljan Bojkoviç, Berat Maloku, Florije Ramadani dhe Bekim Çuni, anëtarë të komitetit.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Avdyl Feka nga Drejtoria për Bujqësi, Branislav Vuksanovic, udhëheqës i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it sloven, Aktore Dërvari, përkthyes si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Stefan Markoviç, kryesues i Komitetit për Komunitete, i cili konstatoi se ekziston shumica për punë.

Komiteti për Komunitete njëlëri aprovoi këtë:

RENDITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Diskutim i hapur për gjendjen e bujqësisë;
3. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Komiteti për Komunitete njëlëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Diskutim i hapur për gjendjen e bujqësisë.

Avdyl Feka, zyrtar nga Drejtoria për Bujqësi – deklaroi se nuk ka përgatitur diçka me shkrim, sepse në momentin e fundit është njoftuar nga drejtoria për këtë takim. Por, do të paraqes para jush disa informata të shkurtra. Pastaj, çfarëdo që ju intereson mund të pyesni lirisht. Bujqësia në komunën e Vushtrrisë është e zhvilluar dhe kultivohen kultura të ndryshme. Zakonisht komuna jonë është e njohur për kultivimin e patates. Juve me

siguri ju intereson subvencionimi i kulturave bujqësore, kriteret e poentimit, përzgjedhjes.

Branislav Vuksanović, udhëheqës i Zyrës për Komunitete dhe Kthim – pyeti se kur do të fillojë aplikimi për subvencionet në bujqësi për këtë vit?

Ekziston një marrëveshje e komunës me “Ibër Lepencin” për ujitje, ku 50% e mbulon komuna, 50% shfrytëzuesi (fermeri). T’i informojmë fermerët për një gjë të tillë në mënyrë që ta shfrytëzojnë këtë mundësi.

Avdyl Feka, zyrtar nga Drejtoria për Bujqësi – tha se subvencionet në bujqësi nga ministria çdo herë janë kryer më herët. Ka disa probleme në Ministrinë e Bujqësisë. Kam pyetur në ministri dhe sipas informatave jozyrtare thirrja për aplikim do të hapet javën e ardhshme.

Marrëveshja e komunës me “Ibër Lepencin” për ujitje është që disa vite. Procedura për shfrytëzimin e ujitjes është se fermeri fillimisht e bënë kontratën me “Ibër Lepencin” dhe në fund të vitit, “Ibër Lepenci” i sjell faturat në komunë, kurse komuna paguan 50%. Shumë qytetarë e shfrytëzojnë këtë mundësi. Prandaj, sugjerimi ynë është që të informohen qytetarët që kanë së paku një hektarë tokë (ku është kriter).

3. Të ndryshme.

Bekim Çuni, anëtar i komitetit – i informoi të pranishmit se më 29.05.2026 disa familje nga komuniteti ashkali kanë përfutur mish të kurbanit nga Kryqi i Kuq i Kosovës – dega në Vushtrri.

Më datë 01.06.2026, Kryqi i Kuq i Kosovës – dega në Vushtrri në bashkëpunim me karabinierët italian të KFOR-it shpërndarë gjëra ushqimore, veshmbathje dhe lodra për një familje nga komuniteti ashkali me kushte të rënda ekonomike.

I falënderoj në emër të komunitetit ashkali për humanizmin dhe mbështetjen për familjet në nevojë.

Më 31.05.2026 e kam dorëzuar një kërkesë në komunë për pastrimin e varrezave të komunitetit ashkali. Kam biseduar me drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe më njoftoi që kërkesën e ka dërguar në NPL “Përparimi”. Po shpresoj se kërkesa jonë do të realizohet.

Mbledhja përfundoi në ora 14:40.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës



Stefan Marković

Stefan Marković
Kryesues i K. për Komunitete